



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 56

Tiranë – E premte, 19 prill 2019

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 230, datë 17.4.2019	Për shpalljen, kategorizimin dhe emërtimin e portit të llojit MBM, në Porto-Romano, Durrës, “Port i hapur për trafik ndërkombëtar”.. 4489
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 232, datë 17.4.2019	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 686, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit”..... 4490



VENDIM
Nr. 230, datë 17.4.2019

ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë,
Këshilli i Ministrave

**PËR SHPALLJEN, KATEGORIZIMIN
DHE EMËRTIMIN E PORTIT TË
LLOJIT MBM, NË PORTO-ROMANO,
DURRËS, “PORT I HAPUR PËR TRAFIK
NDËRKOMBËTAR”**

VENDOSI:

1. Shpalljen, kategorizimin dhe emërtimin e portit detar të llojit MBM (Multi Buoy Mooring), në Porto-Romano, Durrës, si “Port i hapur për trafik ndërkombëtar”, i cili i ka specifikat, si më poshtë vijon:

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 7, të nenit 18, të ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004, “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e

a) Koordinatat gjeografike	Pika A: N- 41° 22'18.532" E- 19 °23'31.052" Pika B: N- 41° 21'48.277" E- 19 °23'46.517" Pika C: N- 41°21'36.625" E- 19 °23'6.361" Pika D: N- 41°22'6.877" E- 19 °22'50.891" Pika P1: N- 41°22'32.520" E- 19°25'19.200"
b) Veprimtaria detare	Ngarkim-shkarkim i naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre;
c) Operativiteti	Port i hapur për trafik ndërkombëtar, 24 orë;
ç) Shfrytëzimi	Faza I: Sipas marrëveshjes koncesionare gjatë kohëzgjatjes së koncesionit miratuar me ligjin nr. 104/2015; Faza II: Pronë e shtetit shqiptar dhe e lirë për t'u shfrytëzuar sipas vullnetit të shtetit, pas përfundimit të koncesionit;
d) Menaxhimi	Faza I: Shoqëria koncesionare “Porti MBM (<i>Multy Buoy Mooring</i>)” sipas marrëveshjes koncesionare miratuar me ligjin nr. 104/2015, gjatë kohëzgjatjes së koncesionit; Faza II: Shteti shqiptar, përfaqësuar nga organet qendrore përgjegjëse, në fushën e porteve dhe zhvillimit ekonomik;
dh) Pronësia	Shteti shqiptar, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave. Kufizime: Në përdorim të shoqërisë koncesionare “Porti MBM (<i>Multy Buoy Mooring</i>)” Porto Romano, Durrës, gjatë kohëzgjatjes së koncesionit;
e) Marrëdhënia me institucionet përgjegjëse për transportin dhe energjinë	Raportim periodik për vëllimin e punës së kryer në port;
ë) Detyrime të tjera	Person kontakti dhe adresë kontakti në çdo kohë. Faqe zyrtare në gjuhën shqipe dhe në anglisht që përmban informacion të plotë për rregullat e funksionimit të portit, tarifatat dhe normat ditore të ngarkim-shkarkimit, si dhe informacion për situatën e anijeve në port.



2. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, të marrin masa që në bashkëpunim me drejtuesit e portit të bëjnë funksionale të gjitha strukturat përkatëse shtetërore, përfshirë komunikimin nominal të personave që do t'i ushtrjnë këto funksione në port.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 232, datë 17.4.2019

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR. 686, DATË 22.11.2017,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES SË
PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 112, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, dhe të neneve 9 e 15, të ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në rregulloren e miratuar me vendimin nr. 686, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas pikës 37, të nenit 2, shtohet pika 38, si më poshtë vijon:

“38. “Korrigjim i dokumentit të planifikimit”, procesi i korrigjimit të dokumentit të planifikimit në fuqi, për rastet kur konstatohen: gabime drejtshkrimore; dy ose më shumë parashikime të ndryshme për të njëjtën zonë/njësi strukturore në dokumente të ndryshme përbërëse të planit; mospërputhje e treguesit të lartësisë në kate me atë të lartësisë në metra; mospërputhje të përcaktimeve në dokumentin e planifikimit me gjendjen faktike të zhvillimeve në territor.”.

2. Pas pikës 2, të nenit 10, shtohet pika 3, me këtë përmbajtje:

“3. Nëse, gjatë zbatimit të dokumenteve të planifikimit, lind nevoja e korrigjimit të dokumenteve të planifikimit, sipas rasteve të përcaktuara në pikën 38, të nenit 2, të këtij vendimi, autoriteti përgjegjës për planifikimin e territorit përgatit një relacion shpjegues dhe njofton Agjencinë për konstatimet. Agjencia, në bashkëpunim me autoritetin përgjegjës për planifikimin, shqyrton dhe vlerëson rastet e konstatuara. Në përfundim të këtij procesi, Agjencia dërgon në KKT kërkesën për miratimin e vendimit për korrigjimin e dokumentit të planifikimit, shoqëruar nga një relacion shpjegues. Vendimi hyn në fuqi pas botimit në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit.”.

3. Nënndarja “ii”, e shkronjës “b”, të pikës 4, të nenit 12 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“ii. Dokumenti i rishikuar i PPV-së miratohet sipas përcaktimeve të nenit 62, të kësaj rregulloreje.”.

4. Referenca ligjore cituar në shkronjën “ç”, të pikës 4, të nenit 52, “... përcaktimet e nenit 8, të kësaj rregulloreje ...”, ndryshohet dhe bëhet “... përcaktimet e nenit 6, të kësaj rregulloreje ...”.

5. Pika 3, e nenit 76 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Zona mund të përmbajë disa kategori përdorimi toke, të cilat duhet të jenë pjesë të një sistemi territorial, në përputhje me nenin 79, të kësaj rregulloreje.”.

6. Pika 3, e nenit 77 ndryshohet, me këtë përmbajtje:

“3. Njësia mund të përmbajë disa kategori/nënkategori përdorimi toke, të cilat duhet të jenë pjesë të një sistemi territorial, në përputhje me nenin 79, të kësaj rregulloreje. Në raste specifike, në një njësi ku mbizotëron një sistem i vetëm territorial, kur, për zhvillimin homogjen të njësisë nuk është e rekomandueshme ndarja e saj, mund të lejohen edhe përdorime që u përkasin sistemeve të tjera territoriale.”.

7. Pika 3, në nenin 86, shfuqizohet.

8. Neni 88 ndryshohet, si më poshtë vijon:



“Neni 88

Zona bujqësore

1. Procesi i planifikimit dhe i zhvillimit në zona bujqësore si dhe ndryshimi i kategorisë përkatëse bazë të përdorimit të tokës në kategori të tjera rregullohet nga legjislacioni i posaçëm për token bujqësore.

2. Propozimi për ndryshimin sipas pikës 1, të këtij neni, kryhet nëpërmjet dokumenteve të planifikimit dhe akteve përkatëse të detyrueshme nga legjislacioni i posaçëm.”

9. Në shtojcën I, nënkategoria “Aktivitete Sportive” ndryshohet në “Aktivitete Sportive dhe Rekreative”.

10. Në shtojcën II bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Kodi për “ZONËN” ndryshon në: “[Kodi i Bashkisë_Kodi i Sistemit Territorial_Kodi i Kategorisë Bazë të përdorimit të tokës_Nr. rendor i zonës]”.

b) Kodi për NJËSINË ndryshon në: “[Kodi i Bashkisë_Kodi i Sistemit Territorial_Kodi i Nënkatëgorisë kryesore të përdorimit të tokës_Nr. rendor i zonës / Nr. rendor i njësisë]”.

c) Kodi për NËNNJËSINË ndryshon në: “[Kodi i Bashkisë_Kodi i Sistemit Territorial_Kodi i Funksionit kryesor_Nr. rendor i zonës / Nr. rendor i njësisë / Nr. rendor i nënnjësisë]”.

ç) Përkufizimi nr. 1 ndryshohet në: “Kodi unik për territorin, sipas çdo niveli të nënndarjes, në përputhje me shtojcën I, të kësaj rregulloreje”.

d) Referenca ligjore, cituar në nr.5, “Sistemi Territorial”/Zonë/ Njësi/ Nënnjësi, me përmbajtje “sipas nenit 72”, ndryshohet në “sipas nenit 75”.

dh) Referenca ligjore cituar në nr.6, “Kategori përdorimi toke”/Zonë/ Njësi/ Nënnjësi, me përmbajtje “sipas nenit 77”, ndryshohet në “sipas nenit 80”.

e) Referenca ligjore cituar në nr.6, “Kategori përdorimi toke”/ Përkufizimi”, me përmbajtje “në

përputhje me nenet 76 e 77” ndryshohet në “në përputhje me nenet 79 dhe 80”.

ë) Referenca ligjore cituar në nr.8, “Përdorime të lejuara”/Zonë/ Njësi/ Nënnjësi, me përmbajtje “Sipas rastit, duke ndjekur përcaktimet e nenit 77”, ndryshohet në “Sipas rastit, duke ndjekur përcaktimet e nenit 80”.

f) Referenca ligjore cituar në nr.8, “Përdorime të lejuara”/Përkufizimi, me përmbajtje “në përputhje me nenet 76 dhe 77”, ndryshohet në “në përputhje me nenet 79 dhe 80”;

g) Referenca ligjore cituar në nr.9, “Përdorime të ndaluara”/Zonë/Njësi/ Nënnjësi, me përmbajtje “Sipas rastit, duke ndjekur përcaktimet e nenit 77”, ndryshohet në “Sipas rastit, duke ndjekur përcaktimet e nenit 80”;

gj) Referenca ligjore cituar në nr.9, “Përdorime të ndaluara”/Përkufizimi, me përmbajtje “Në përputhje me nenet 76 dhe 77”, ndryshohet në “Në përputhje me nenet 79 dhe 80”.

h) Referenca ligjore cituar në nr.10, “Përdorime të kushtëzuara”/Zonë/ Njësi/Nënnjësi, me përmbajtje “Sipas rastit, duke ndjekur përcaktimet e nenit 77”, ndryshohet në “Sipas rastit, duke ndjekur përcaktimet e nenit 80”.

i) Referenca ligjore cituar në nr.10, “Përdorime të kushtëzuara”/ Përkufizimi, me përmbajtje “në përputhje me nenet 76 dhe 77”, ndryshohet në “në përputhje me nenet 79 dhe 80”.

j) Referenca ligjore cituar në nr.11, “Nënkategori përdorimi toke”/ Njësi/ Nënnjësi, me përmbajtje “Sipas nenit 76”, ndryshohet në “Sipas nenit 79”.

k) Referenca ligjore cituar në nr.12, “Funksion”/Nënnjësi, me përmbajtje “Sipas nenit 76”, ndryshohet në “Sipas nenit 79”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 56 lekë